



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Sh.II.nr.1696/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri në çështjen përmbartimore të kreditorit NTSH “Adi” me seli në Magjistralen Ferizaj-Shkup, me numër të biznesit 70240302 me pronar XH.M., përfaqësuar me autorizim nga Marigona Gashi avokate në Lipjan, kundër debitorit “Alko Group” Sh.a me seli në Prishtinë, rr. “Bedri Berisha” Objekti B, Lokali nr.1, me numër unik identifikues 811290328, të cilin me autorizim e përfaqëson Azem Islamaj, avokat nga Prishtina, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2314/22 të datës 29.09.2023, me datë 24.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e bazuar ankesa e kreditorit NTSH “Adi”, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2314/22 të datës 29.09.2023, **PRISHET** dhe çështja i kthehet Gjykatës Komerciale, Dhomave të Shkallës së Parë në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2314/22 të datës 29.09.2023, në dispozitiv të aktvendimit ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit, “Alko Group” Sh.A, ashtu që Urdhri Përmbarimor P.nr.406/22, i lejuar më datë 28.06.2022, nga Përmbaruesi Privat Bardh B.Tasholli, është shfuqizuar.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori për shkak të shkejeve të ligjit të procedurës përmbarimore, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për shkak të vërtetimit të gabuar të së drejtës materiale si dhe për shkak të shkeljes së dispozitave të LMD-së, me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2314/22 të datës 29.09.2023, apo ndryshohet apo lënda të kthehet në rivendosje.

Përgjigjie në ankesë nuk ka paraqit debitori.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori NTSH “Adi” me datën 28.06.2022, ka paraqitur propozimin për përmbarim mbi bazën e dokumentit të besueshëm - faturës nr. 11-2020 ka lejuar urdhrin për përmbarim P.nr.406/22, të datës 28.06.2022, me të cilin është urdhëruar debitori, që në afat prej 7 (shtatë) ditësh pas pranimit të këtij urdhri, ti paguaj kreditorit tërësisht borxhin, në shumën prej 4.016.00 €, shpenzimet e procedurës përmbarimore si dhe shpenzimet e avokatit për përpilimin e propozimit për përmbarim sipas TOAK.

Debitori, në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor në tërësi, duke theksuar se sipas kontratës së datës 28.09.2020, kreditori ka qenë i obliguar që të kryej

izolim e tarracës ku me kontratë janë paraparë pagesë prej 15 € për m2, e që në nenin 4 par. 4 të kësaj kontrate shprehet decidivisht se me përfundimin e punëve, bëhet matja përfundimtare e cila vërtetohet nga punëdhënësi dhe punëmarrësi, si dhe se çmimet faturohen varësisht nga punimet e kryera. Shton se fatura është jologjore sepse është lëshuar me datën 22.10.2022 pas nënshkrimit të kontratës, pa përfundimin e punimeve siç janë përshkruar në kontratë, gjë që ka dërguar në pamundësinë e debitorit për realizimin e pagesës së tërësishme. Tutje thekson se faturën e lëshuar akoma pa përfunduar punët e kemi refuzuar ta nënshkruajmë dhe vulosim duke e kthyer pas faturën dhe në të njëjtën janë shënuar punët që duhet të realizohen e të cilat nuk janë realizuar asnjëherë, ndërsa pagesa në shumë prej 4,000.00€ është përmbushur për punimet e realizuara, ndërsa pjesa tjetër do të realizohet pas përfundimit të tërësishëm të punëve të kontraktuara.

Kreditori, në përgjigje në prapësim, ka theksuar se prapësimi i debitorit nuk është i bazuar në nenin 71 të LPP-së, në të cilin nen janë përcaktuar shkaqet për paraqitjen e prapësimit. Shton se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit se nuk e ka pranuar faturën, ku nga dëshmia e pagesës shihet qartë se debitori e ka pranuar pasi që të njëjtën edhe e ka paguar në shumë prej 3.000,00 euro me çka ka mbete për pagesë edhe për shumën prej 5,016 euro.

Me datë 08.09.2022, përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin e propozuar, përkatësisht korrigjimin e propozimit për përmbarim të parashtruar nga kreditori, me të cilin urdhërohet debitori që në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij urdhri, ti paguaj kreditorit tërësisht borxhin, në shumën prej 5,016.00 me kamatë vonesë në lartësi prej 8 % vjetore, nga 3 data kur është dashur të paguhej fatura, e deri në pagesën definitive si dhe të gjitha shpenzimet e përmbarimit, në kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Debitori, ka parashtruar prapësim ndaj urdhrin përmbarimore me të cilin është lejuar korrigjimi i propozimit për përmbarim, të cilin e kundërshtoi në tërësi, duke theksuar se sipas kontratës së datës 28.09.2020, kreditori ka qenë i obliguar që të kryej izolimin e tercës ku me kontratë janë paraparë pagesë prej 15 € për m2, në nenin 4 par 4 të kësaj kontrate shprehet decidivisht se me përfundimin e punëve, bëhet matja përfundimtare e cila vërtetohet nga punëdhënësi dhe punëmarrësi, si dhe se çmimet faturohen varësisht nga punimet e kryera. Shton se fatura është jologjore sepse është lëshuar me datën 22.10.2022 pas nënshkrimit të kontratës, pa përfundimin e punimeve siç janë

përshkruar në kontratë, gjë që ka dërguar në pamundësinë e debitorit për realizimin e pagesës së tërësishme. Tutje thekson se fatura e lëshuar akoma pa përfunduar punët e kemi refuzuar ta nënshkruajmë dhe vulosim duke e kthyer pas faturën dhe në të njëjtën janë shënuar punët që duhet të realizohen e të cilat nuk janë realizuar asnjëherë, ndërsa pagesa në shumë prej 4000.00€ është realizuar punimet e realizuara, ndërsa pjesa tjetër do të realizohej pas përfundimit të tërësishëm të punëve të kontraktuara.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.2314/22 të datës 29.09.2023, në dispozitiv të aktvendimit ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit, “Alko Group” Sh.A, ashtu që Urdhri Përmbarrimor P.nr.406/22, i lejuar më datë 28.06.2022, nga Përmbarruesi Privat Bardh B.Tasholli, është shfuqizuar. Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka gjetur se fatura mbi bazën e së cilës është lejuar përmbarrimi nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për arsye se e njëjta nga debitori është pranuar me vërejtje si në vijim: të rregullohet umbersai, të zbritet krani, të shënohet se 50 % paguhet pas përfundimit të punimeve dhe 50 % pas një viti.

Gjykata Komerciale -Dhoma e shkallës së Dytë, qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i ankimuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë me aktvendimin ankimuar KPPP.nr.2314/22 të datës 29.09.2023, me të cilin ka aprovuar prapësimin e debitorit nuk ka vendosur në mënyrë të drejtë pasi që nuk ka vërtetuar se dokumenti përmbarrimor-fatura a i plotëson kushtet sipas ligjit për të qenë dokument i besueshëm.

Gjykata e Shkallës së Parë ka shfuqizuar urdhrin përmbarrimor P.nr.406/22, i lejuar më datë 28.06.2022, duke u mbështetur në faturën nr. 11-2020 sipas të cilës e njëjta nga debitori është pranuar me vërejtje. Mirëpo në shkresat e lëndës Gjykata e Shkallës së Parë nuk ka vlerësuar drejtë faktin lidhur me faturën në fjalë, sepse në faturë është shënuar të rregullohet umbersai, të zbritet krani, të shënohet se 50 % paguhet pas përfundimit të punimeve dhe 50 % pas një viti, pasi që ky shënim nuk është e qartë, ngase nga kjo faturë është e nënshkruar nga debitori dhe është paguar

një pjesë të borxhit për të cilën nuk dihet sakt për cilën pjesë ka paguar debitori, sepse në bazë të këtij shënimi në faturë del që 50% do të paguhet për punët e përfunduar si dhe 50% pas një viti, si dhe nuk është e qartë se ky mbishkrim a është bërë në momentin e lëshimit dhe pranimit të faturës apo është bërë pas lëshimit të faturës ngase lidhur me këtë mbishkrim nuk figuron ndonjë nënshkrim nga palët, e as datë se kur është bërë ky mbishkrim, po ashtu nga mbishkrim i faturës nuk është e qartë se a ka të bëjë me kthim të faturës.

Andaj, gjykata e shkallës së parë, nuk ka shqyrtuar drejtë çështjen, gjegjësisht lidhur me konstatimin në faturë, andaj, me qëllim të harmonizimit të shkresave në lëndë, gjykata e shkallës së parë duhet të vlerësoj nëse fatura a i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm konform dispozitave ligjore të LPP-së, ashtu që me qëllim të konstatimit real të detyrimeve të debitorit marrë për bazë edhe pretendimet e palëve në procedure, kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë duhet ta këtë parasysh nenin 73 paragrafi 1 të LPP-së, i cili thotë, se: *“Gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore. Përrjashtimisht Gjykata mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimit. Gjykata do të njoftojë të gjitha palët për dëgjimin publik. Nëse Gjykata vendos të mbajë seancë dëgjimore publike, seanca dëgjimore do të mbahet brenda pesë (5) ditëve, kur kërkohet që përgjigjet ndaj prapësimit të pranohet nga gjykata, arsye këto nga të cilat rezulton se aktvendimi i ankimuar duhet të anulohet dhe çështja të kthehet në procedim të serishëm në gjykatën e shkallës së parë.*

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se në këtë rast nuk janë përmbushur kushtet ligjore për të aprovuar prapësimin e debitorit prandaj, ankesën e kreditorit e pranoi si të themeltë dhe çështjen vendosi t’ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Në ri procedurë, Gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në kuptim të vërejtjeve të sipërpërmendura, të vërtetoj në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike të vlerësojë dokumentin përmbarimor, se a i plotëson kushtet nga neni 29 par.3 të LPP-së, eventualisht të hapë edhe seancë për ti vërtetuar pretendimet e palëve në këtë çështje përmbarimore, e pas kësaj të vazhdojë procedurën konform dispozitave ligjore duke marrë aktvendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika d), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-DHOMA E SHKALLËS SË DYTË

K.Dh.Sh.II.nr.1696/23 me datën 24.04.2024

Gj y q t a r j a,
Franciska Zhitija-Ymeri